

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-62/23-07
Prishtinë, më 18 tetor 2007
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Bislim Hoti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari hapi seancën dhe i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Ndërkohë, Grupi Parlamentar i ORA-s, në bazë të Rregullës 29.2 të Rregullores së Kuvendit, ka propozuar me shkrim një amendament në rendit e ditës: Debat lidhur me grevën e urisë të SBASHK-ut.

Teuta Sahatqija, kryetare e Grupit Parlamentar të ORA-s, e arsyetoi propozimin që Kuvendi të debatojë lidhur me grevën e urisë të SBASHK-ut dhe të gjejë zgjidhje për situatën e krijuar.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të ORA-s. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----30;
Kundër-----36.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, nuk e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të ORA-s.

Pastaj, seanca i zhvilloi punimet sipas këtij

R E N D I T Ë D I T Ë S

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 27 shtator 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,
4. Vazhdimi i procedimit të amendamenteve në Rregulloren e Punës të Kuvendit;
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për telekomunikacion lidhur vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor;
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 27 shtator 2007

Procesverbali i seancës plenare të 27 shtatorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me shkresën e Kryeministrit të Kosovës, Agim Çeku, me të cilën kishte njoftuar se nuk do të jetë i pranishëm në punimet e seancës së sotme për shkak të takimeve që kishte me zyrtarët e NATO-s, si dhe të angazhimeve të tjera. Përgjigjet e Kryeministrit për pyetjet që i janë parashtruar priten për seancën e radhës.

Në pajtim me rregullat procedurale, kryetari i Kuvendit lejoi që deputetët t'i lexojnë pyetjet.

Deputeti **Nait Hasani** paraqiti pyetje për Kryeministrin e Kosovës, Agim Çeku: Pse Qeveria e Kosovës nuk e ka proceduar Projektligjin për pensionistët dhe kush e ka penguar procedimin e tij?

Përgjigjja pritet për seancën e radhës.

Deputetja **Gjulishene Berisha** paraqiti pyetje për Kryeministrin e Kosovës, Agim Çeku: Çfarë masash ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe si funksionon Zyra për Barazi Gjinore?

Përgjigjja pritet për seancën e radhës.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** paraqiti pyetje për Kryeministrin e Kosovës, Agim Çeku: Çfarë po ndodhë me Strategjinë e planifikimit zhvillimor të Kosovës?

Përgjigjja pritet për seancën e radhës.

Deputeti **Hydajet Hyseni** paraqiti pyetje për Qeverinë e Kosovës dhe për Ministrinë për Kthim: Çka kanë bërë për t'ia përmirësuar kushtet e jetesës të të zhvendosurve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, si dhe për kthimin e tyre në vatrat e veta?

Ndërkaq, për Kryeministrin e Kosovës dhe për Grupin Negociator paraqiti pyetjen: Cila është e vërteta për Traktatin e miqësisë dhe të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe për Deklaratën e New Yourk-ut?

Përgjigjet priten për seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, **Ardian Gjini**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Gjini** arsyetoi: qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për mbrojtjen e mjedisit, i radhitur në 12 kapituj dhe në 102 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministrit **Gjini**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Shaban Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Xhelal Canziba**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Ferid Agani**, si dhe deputetët: **Zylfije Hundozi dhe Nekibe Kelmendi**. Këto diskutime janë dhënë në trasnkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 64;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit.

Kuvendi ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor – si komision përgjegjës dhe raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj sipas afatit të përcaktuar me Rregullore të Punës së Kuvendit dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

4. Vazhdimi i procedimit të amendamenteve në Rregulloren e Punës të Kuvendit

Kryetari i njoftoi deputetët se Amendamentet në Rregulloren e Punës të Kuvendit janë shqyrtuar në seancën plenare të 27 shtatorit 2007, por në mungesë të kuorumit, votimi i amendamenteve është shtyrë për seancën e radhës.

Ndërkohë, amendamentet janë korrigjuar në tri versionet gjuhësore dhe teksti i spastruar u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit miratoi amendamentin e parë, me riformulimin e deputetit Hydajet Hyseni, si vijon: **“Kalendari i punës së Kuvendit:** Është dokument zyrtar i Kuvendit i cili përmban të gjitha çështjet që presin të shqyrtohen në Kuvend. Kalendari i punës përgatitet, publikohet dhe shtypet para secilës seancë plenare, në përputhje me këtë Rregullore, me përjashtim të seancës konstituive. Në kohën kur Kuvendi nuk ka seancë, Kalendari i punës përgatitet çdo dy javë dhe u shpërndahet deputetëve në mënyrë elektronike. Kalendari i punës publikohet në Internet në faqen zyrtare të Kuvendit. Publikimi autorizohet nga sekretari i Kuvendit. Çështjet që presin të shqyrtohen në Kuvend përfshijnë: mocionet e parashtruara, rezolutat, deklaratat, projektligjet, pyetjet për Qeverinë, kërkesat për interpelanca, raportet e komisioneve dhe raportet vjetore të Qeverisë”.

Kuvendi, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit nuk miratoi amendamentet: 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi vetëm amendamentin nr.1, i cili behët pjesë e përkufizimeve të Rregullores së Punës të Kuvendit.

5 . Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për telekomunikacion lidhur me vërejtjet e UNMIK- ut në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor

Kryetari i njoftoi deputetët se Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 11 janar 2007 dhe i është dërguar për shpallje PSSP-së. Por, PSSP-ja me shkresën nr. 3658, datë 18.08.2007 ka paraqitur vërejtjet konkrete në ligj. Komisioni për Transport dhe Telekomunikacion, në cilësi të komisionit funksional, ka shqyrtuar vërejtjet e UNMIK-ut dhe Kuvendit i ka rekomanduar amendamente në këtë ligj.

Ai i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një. Kuvendi i miratoi këto amendamente:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe11.

Kryetari konstatoi: Amendamentet e miratuara duhet të inkorporohen në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor, i cili i dërgohet PSSP-së, për shpallje.

6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike lidhur me vërejtjet e NMIK-ut në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër

Kryetari i njoftoi deputetët se Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 26 janar 2007 dhe i është dërguar për shpallje PSSP-së. Por, PSSP-ja nuk e ka shpallur Ligjin. Me shkresën nr. 3440, datë 20.06.2007, ka paraqitur vërejtjet konkrete në ligj.

Komisioni për Shërbime Publike, në cilësi të komisionit funksional, ka shqyrtuar vërejtjet e UNMIK-ut dhe Kuvendit i ka rekomanduar amendamente në këtë ligj.

Ai i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një. Kuvendi i miratoi këto amendamente:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Kryetari konstatoi: Amendamentet e miratuara duhen të inkorporohen në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër, i cili i dërgohet PSSP-së, për shpallje.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 11: 35 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale